



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 prill 2015  
Nr. ref.: KK 109 /15

**Z. Sylë Hoxha**

Ushtrues i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryetar i Këshillit Prokurorial të Kosovës  
Prishtinë, Republika e Kosovës

**Re:** Zbatimi i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KI99/14 dhe KI100/14, të 8 korrikut 2014

I nderuari z. Hoxha,

Në vijim të komunikimit me ju, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), përsërit se kërkimi i informatave është në pajtim me autoritetin e Gjykatës për të monitoruar zbatimin e vendimeve të saj, në pajtim me nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe me rregullin 63 [Zbatimi i vendimeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me praktikën e saj konstante kushtetuese.

Pas shqyrtimit të tërë dokumenteve të dorëzuara nga ju, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KI99/14 dhe KI100/14, i 8 korrikut 2014, është zbatuar me anulimin e vendimeve të kontestuara KPK nr. 146/2014 dhe KPK nr. 151/2014 për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit dhe me përsëritjen e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Sa i përket ndonjë çështjeje tjetër që mund të ketë dalë nga procedura e përsëritur e zgjedhjes, ato nuk janë brenda juridiksionit të Gjykatës, pasi asnjë kërkesë në Gjykatë nuk është parashtruar nga një palë e autorizuar.

Prandaj, Gjykata nuk mund të komentojë lidhur me ndonjë aspekt të mundshëm kushtetues të procedurës së përsëritur të zgjedhjes.

Në këtë mënyrë, Gjykata rikujton se çdo çështje lidhur me procedurën e përsëritur, e cila mund të ketë bazë kushtetuese për t'u diskutuar, duhet t'i referohet Gjykatës në mënyrë ligjore, pasi Gjykata nuk mund të veprojë *ex officio*.

Sa i përket procedurës së përsëritur të zgjedhjes, tani i takon Presidentes së Republikës së Kosovës që, në bazë të mandatit të saj kushtetues, të vlerësojë atë procedurë.

Gjykata rithekson se ajo është një organ i pavarur për mbrojtjen e Kushtetutës dhe për sigurimin e respektimit të ndarjes së pushteteve dhe të sundimit të ligjit.

Kjo letër është diskutuar dhe është vendosur njëzëri nga Gjykata në përbërje të plotë në seancën e saj të 17 prillit 2015.

Sinqerisht juaji,



Prof. dr. Enver Hasani  
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

